Gezim Bybeni
mora nji kopje. 03.04.08



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**KESHILLI KOMBETARE I UJIT**
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN – BUNE**

Adresa: Qendra Transferimit te Teknologjive Bujqesore.Kati 3-te,Cel.0682081245

**Nr.** 314/1 **Prot.**

**Shkoder,dt.** 31.03 **2008**

## I N F O R M A C I O N

### "MBI PERDORIMIN E BURIMIT UJORE "LUMI I VALBONES" FSHATI KLYSYRE PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA SUBJEKTI "ALB – IT ENERGY "Sh.p.k. H/C KLYSYRE 1 .

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nga " ALB – IT ENERGY " Sh.p.k. per perdorim te burimit ujor LUMI VALBONES per prodhim energjie elektrike nen 10 MW, dhe se propozimi i mesiperm, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin-Bune, nuk ka te beje me projekte, per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga subjekti i mesiperm, vepra e marrjes se ujit do te ndertohet ne FSHATIN DRAGOBI ne kuoten 521,5 m mbi nivelin e detit dhe do te mbledhe ujrat e lumit te Valbones. Godina e centralit eshte parashikuar te ndertohet ne kuoten 382,5 m mbi nivelin e detit. Prurja mesatare shume vjecare e lumit ne aksin e vepres se marrjes eshte 9.3 M3 /sek, ndersa subjekti do te shfrytezoje nje prurje prej Q= 11 M3/sek.

Subjekti gjate periudhes se veres nuk do pengoje vaditjen.

Ky informacion jepet nga K.B.U. Drin-Bune Shkoder, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 "PER KONCESIONET ", dhe ne zbatim te tij te germes b, pika 1, kreu IV, i V.K.M.-se nr. 27, dt. 19.01.2007, "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve", per plotesim dokumentacioni.

**PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

**SEKRETARI**

**Ing. Osman DELTINA**

**K R Y E T A R I**

**Maxhid CUNGU**

REPUBLIKA E SHQIPERISE KESHILLI KOMBETAR I UJIT KESHILLI I BASENIT DRIN-BUNE